SHPDK

Association of Wood Processors of Kosovo

SHOQATA E PËRPUNUESVE TË DRURIT TË KOSOVËS

RAPORT I PUNËS SË SHPDK-së

Periudha: Janar – Dhjetor 2024

Rr. Murat Mehmeti, nr.58
Prishtinë 10000 Republika e Kosovës
www.kosovowood.org

SHPDK

Association of Wood Processors of Kosovo

PËRMBAJTJA

Rreth SHPDK-së .....
Misioni .....
Hyrje.....
Struktura organizative e SHPDK-së .....
Shërbimet e SHPDK-së .....
Projektet .....
Rezultatet dhe të Arriturat.....
Anëtarët e SHPDK-së .....

SHPDK
Association of Wood Processors of Kosovo

RRETH NESH

Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK) është themeluar në vitin 2004.
SHPDK është organizatë jofitimprurëse për kompanitë në
sektorin e përpunimit të drurit.
Roli i SHPDK-së është të mbështesë këto kompani,
dhe të avokoj në emër të tyre në nivelet legjislative dhe rregullore.
SHPDK promovon interesat e kompanive të përpunimit të drurit në Kosovë.
SHPDK mbështet këto kompani për të zgjeruar rrjetëzimin me
bizneset vendore dhe ndërkombëtare, për të përmirësuar produktet dhe cilësinë, për të përmirësuar teknologjitë, dhe për të rritur produktivitetin, me fokus përfundimtar në rritjen e eksporteve.

MISIONI

- **Promovimi i produkteve të drurit të prodhuara në Kosovë**
- **Identifikimi i klientëve dhe partnerëve të biznesit të huaj potencial**
- **Rritja e anëtarësisë dhe mbështetja e anëtarëve me pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, misione biznesi, takime dhe ngjarje B2B**
- **Ofrimi i trajnimeve profesionale për fuqinë punëtore ekzistuese dhe të ardhme të industrisë**
- **Ofrimi i udhëzimeve për prodhuesit e Kosovës dhe të ndihmohen ata për të qenë konkurrues në tregjet ndërkombëtare dhe vendore**
- **Të ndihmohen kompanitë të ndjekin tendencat globale dhe moderne në sektorin e tyre**
- **Ofrimi i mbështetjes së nevojshme që ato të ngritin veten si marka të mirënjohura**

SHPDK
Association of Wood Processors of Kosovo

HYRJE

Është kënaqësi e veçantë të paraqes këtë raport te periudhes Janar – Dhjetor 2024 që pasqyron punën e zellshme dhe të përkushtuar të Shoqatës së Përpunuesve të Drurit të Kosovës lidhur me përpjekjet e saja për mbështetje të kompanive për të zgjeruar rrjetëzimin me bizneset vendore dhe ndërkombëtare, për të përmirësuar produktet dhe cilësinë, për të përmirësuar teknologjitë, dhe për të rritur produktivitetin, me fokus përfundimtar në rritjen e eksporteve.
Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK) është themeluar në vitin 2004. SHPDK është organizatë jofitimprurëse për kompanitë në sektorin e përpunimit të drurit. Roli i SHPDK-së është të mbështesë këto kompani, dhe të avokoj në emër të tyre në nivelet legjislative dhe rregullatore. SHPDK promovon interesat e kompanive të përpunimit të drurit në Kosovë.
Qëllimi i SHPDK-së është që të përkrah zhvillimin modern ekonomik të industrisë së drurit në Kosovë.

Gjate kësaj periudhe ne kemi implementuar shumë projekte zhvillimore të cilat kanë pasur për qëllim promovimin e produkteve të drurit të prodhuara në Kosovës, pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, misione biznesi, takime dhe ngjarje B2B, etj.

SHPDK ka zhvilluar aktivitete të promovimit të industrisë së drurit në Kosovë, me qëllim të rritjes së tregut të produkteve të drurit të Kosovës, dhe të ndihmohen ata për të qenë konkurrues në tregjet ndërkombëtare dhe vendore.

SHPDK ka zhvilluar projekte avokuese me qëllim të nxitjes së politikave me të favorshme fiskale. Të gjitha këto kanë një qëllim stimulimin e bizneseve kosovare, të ndihmohen ato të ndjekin tendencat globale dhe moderne në sektorin e tyre.

SHPDK ka arritur të zhvillojë një rrjet të gjerë të kontakteve dhe të bashkëpunimit me ministri, asociacione të biznesit, ndërmarrës, institucione financiare, OJQ ndërkombëtare dhe vendore, me ekspert ndërkombëtare dhe vendor, me organizata qeveritare të huaja të cilat veprojnë në Kosovë dhe jashtë saj.


Për të gjitha të arriturat dhe rezultatet e kesaj periudhe falënderojmë stafin, bordin dhe anëtaret e SHPDK-së, që ishin pjesë e aktiviteteve dhe të arriturave tona.

Falenderojmë donatorët dhe institucionet tona për përkrahjen e fuqishme gjatë gjithë kësaj kohe, pa te cilët nuk do te ishte i mundur realizimi i këtyre aktiviteteve dhe arritja e këtyre rezultateve:

GIZ Entrepreneurship Promotion
GIZ Fit for Jobs
IREX- Private Sector-Led Workforce Development
Swisscontact - FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)
MINT – KIESA
Swisscontact - PPSE

Gjithashtu falenderojmë bashkëpuntorët nga kompanitë Appdec dhe PIAR Creations në realizmin e aktiviteteve dhe për korrektesinë në punën e tyre.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHPDK-së



Kuvendi i SHPDK-së

Kuvendi përbëhet nga 63 anëtarët e SHPDK-së

Bordi i SHPDK-së

Zenel Kelmendi ..... Kryetar i SHPDK-së
Hashim Deshishku ..... Nënkryetar i SHPDK-së
Sheqer Ukaj ..... Anëtar i Bordit
Kreshnik Shehu .....Nënkryetar i dytë/Thesarist i SHPDK-së
Miftar Veseli ..... Anëtar i Bordit
Mentor Zekaj ..... Anëtar i Bordit
Ekrem Shahini ..... Anëtar i Bordit
Nazmi Mehmetaj ..... Anëtar i Bordit
Imri Sopaj ..... Anëtar i Bordit

Personeli

Arieta Vula ..... Drejtoreshë Ekzekutive

Naser Pozhegu ..... Projekt Menaxher dhe Financa

Liridona Kastrati ..... Koordinatore e Projekteve

Halil Kaja ..... Financier

SHËRBIMET E SHPDK-së gjate vitit 2024

1. Promovimi i produkteve të drurit të prodhuara në Kosovës.

Promovimi i produkteve të drurit të prodhuara në Kosovë është një mundësi të inkurajojë zhvillimin ekonomik lokal dhe të promovojë qëndrueshmërinë mjedisore.

SHPDK kryen sherbime promovimi për anëtaret e saj përmes kanaleve të ndryshme promovuese si:

- Promovim në web faqen e saj ***www.kosovowood.org***.
- Promovim përmes **Katalogut** të dizajnuar me rreth 70 kompani të industrisë së përpunimit të drurit.
- Promovim përmes **mediave sociale**, i cili me shume perpjekje eshte arritur me sukses, ku prezenca e kompanive përmes shoqatës ka qenë shumë aktive, dhe është arritur një audiencë e knaqshme.
- Promovim përmes **ekspozimit** në panaire nderkombetare.
- Promovim përmes misioneve **B2B**.
- Rrjetizim midis kompanive vendore dhe atyre ndërkombëtare.

2. Identifikimi i klientëve dhe partnerëve të biznesit të huaj potencial.

Identifikimi i klientëve dhe partnerëve të biznesit të huaj në industrinë e drurit është një proces i rëndësishëm për kompanitë Anëtare që operojnë në këtë sektor. Kjo eshte arritur me:

- Pjesëmarrjen e antarëve në ngjarje ndërkombëtare, panaire të ndryshme, takime B2B, vizita dhe konferenca përkatese për industrine e drurit, pjesëmarrje në grupet punuese me fokus industrinë dhe strategjinë e përpunimit të drurit.
- Krijimin e platformave online, pra përmes Showroomit (E-commerce) i cili është duke u krijuar anëtaret do të kenë mundësi të tërheqin klientë të rinjë duke ofruar produkte dhe shërbime të pritshme për ta.
- Bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare ose rrjetet e ndërmarrjeve të lidhura me industrinë e drurit duke marrur pjesë në ngjarje dhe takime të tyre, prej të cilës Anëtarët bëjnë kontakte të rëndësishme me klientë dhe partnerë potencialë.

3. Rritja e anëtarësisë dhe mbështetja e anëtarëve me pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, misione biznesi, takime dhe ngjarje B2B.

SHPDK në vazhdimësi është në rritje të numrit të Anëtarësisë përmes një strategjie marketingu dhe promovimi duke prezentuar vlerën dhe avantazhet e antarësisë në Shoqatë.

SHPDK tashmë shumë vite projekton, organizon dhe menaxhon panaire të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku mund ti cekim panairet në te cilat antarët tash e disa vite kanë shprehur gatishmërinë për ekspozim të produkteve të tyre:

- Imm Cologne në Gjermani.
- Swiss Bau në Basel/Zvicër,
- Stockholm Furniture Fair në Suedi
- Konventa e Industrisë së Drurit të Kosovës

SHPDK-ja bën organizimin e konferencave, seminareve dhe workshope, pjesëmarrje në vizita dhe konferenca jashtë vendit me interes për kompanitë anëtare. Ndër organizimet më të rëndesishme mund ti cekim:

- Takimet B2B/ rrjetëzime gjatë Konventës se Industrisë së Drurit te Kosoves .
- Takimet B2B gjatë Swiss Bau Zvicër mes kompanive të industrisë së drurit të Kosovës me kompani kryesisht të diaspores në Zvicër.
- Takimet B2B gjatë panairit Imm Cologne në Gjermani mes kompanive të industrisë së drurit të Kosovës me kompani kryesisht të diaspores në Gjermani.

4. Ofrimi i trajnimeve profesionale për fuqinë punëtore ekzistuese dhe të ardhme të industrisë.

SHPDK-ja organizon trajnime të ndryshme profesionale për fuqinë punëtore ekzistuese dhe të ardhme të industrisë si:

- Instruktor në Vendin e Punës.
- Soft Skills Training.
- Trajnime Profesionale në Industrinë e përpunimit të drurit.
- Trajnime, praktikë pune dhe punësim i të papunëve në industrinë e drurit.

5. Ofrimi i udhëzimeve për prodhuesit e Kosovës dhe të ndihmohen ata për të qenë konkurrues në tregjet ndërkombëtare dhe vendore.

SHPDK-ja ofron informata me interes për sektorin për anëtarët, informata për industrinë e drurit dhe statistikat për treg, informata për eksportin e prodhimeve vendore etj, shpallje dhe grante të ndryshme, mundësi biznesi, mundësi certifikimi të produkteve etj.

SHPDK ofron trajnime dhe udhëzime për kompanitë antare që dëshirojnë të marrin pjesë në misione ndërkombëtare (ekspozime, b2b, rrjetëzime, pjesemarrje në konferenca).

6. Të ndihmohen kompanitë të ndjekin tendencat globale dhe moderne në sektorin e tyre

Pjesëmarrja në vizita panaire dhe konferenca është një mënyrë e shkëlqyer për të ndihmuar industrinë të ndjekë trendin. Këto ngjarje ofrojnë një platformë të shkëlqyer për kompanitë për të eksploruar inovacionet,

të ndajnë idetë, dhe të bëjnë lidhje me aktorë të tjerë në fushën e tyre. Këtu janë disa mënyra se si pjesëmarrja në këto ngjarje ndihmon industrinë të ndjekë trendet:

Eksplorimi i teknologjive të reja: Konferencat dhe panairet janë vendet ku shpesh paraqiten teknologji të reja dhe inovative. Duke marrë pjesë, përfaqësuesit nga kompanitë mund të mësojnë për teknologjitë e fundit dhe të shikojnë se si ato mund të përdoren në industrinë e tyre.

Ngritja e ndërgjegjësimit për trendet aktuale: Duke dëgjuar prezentime nga ekspertë të fushës, ata mund të informoheni mbi trendet aktuale dhe sfidat që përballon industria.

Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi: Konferencat dhe panairet ofrojnë mundësinë për të bërë lidhje me profesionistë të tjerë, klientë potencialë, dhe partnerë të mundshëm.

Përmirësimi i aftësive dhe dijes: Konferencat shpesh ofrojnë seminare dhe workshope të specializuara që mund të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive dhe njohurive.

7. Ofrimi i mbështetjes së nevojshme që ato të ngritin veten si marka të mirënjohura

Pjesëmarrja aktive në evente ndërkombëtare është një mjet i rëndësishëm për të ngritur profilin e sektorit të drurit dhe për të tërhequr investime të reja në këtë industri. Disa nga mënyrat se si kjo pjesëmarrje kontribuon në arritjen e këtyre qëllimeve janë:

Njohja e Industrisë: Pjesëmarrja në evente ndërkombëtare ja mundëson Shoqatës të prezantojë potencialin dhe fuqinë e sektorit të drurit në nivel global. Kjo njohje mund të rrisë ndërgjegjësimin ndër investitorët e huaj për mundësitë që ofron kjo industri.

Prezantimi i ofertave: Eventet ndërkombëtare ofrojnë një platformë të përshtatshme për të prezantuar produktet dhe shërbimet e industrisë së drurit. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të treguar cilësinë, inovacionet dhe konkurrencën e sektorit.

Krijimi i lidhjeve: Pjesëmarrja në këto evente mund të sjellë kompanitë në kontakt me investitorët e huaj, bizneset ndërkombëtare dhe partnerë potencialë. Ky rrjetëzim dhe bashkëpunim mund të sjellë investime të reja dhe marrëveshje biznesi.

Nxitja e Investimeve të huaja: Duke prezentuar sektorin e drurit në mënyrë tërheqëse dhe duke ofruar informacion të rëndësishëm për klimën e investimeve në vend, Shoqata mund të nxisë investitorët e huaj të shqyrtojnë mundësitë për të investuar në industrinë e drurit.

8. Avokim dhe Lobim

SHPDK-ja bën avokim dhe lobim për mbrojtjen e interesave të bizneseve në industrinë e drurit të Kosovës duke marr pjesë takime të rëndësishme dhe të rregullta, anetare në këshille dhe grupe punuese tek institucionet, donatorët egzistues dhe të rinjë, ministritë në departamentet perkatese:

- Udheheqëse e Këshillit Sektorial për zhvillim të fuqisë punëtore në sektorin e përpunimit të drurit, mbështetur nga IREX- USAID
- Udheheqëse e strategjisë për industrinë e drurit në punëtoritë për Strategjinë e Specializimit të Mençur, udhëhequr nga Zyra për Planifikim Strategjik në kuader të ZKM.
- Antare e Keshillit në Task Forcën për Arsimin Dual, udhëhequr nga MASHTI.
- Antare në forumin për zhviliimin e politikave industriale të organizuara nga MINT për interesa të industrise së drurit.
- Antare e këshillit në Agjencinë e pyjeve të Kosovës udhëhequr nga Ministria e Bujqësise, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural.
- Pjesëmarrje e rregullt dhe angazhim në Grow Agency, mbështetur nga ZKM të Kosovës.

9. Ndërmjetsime – Fasilitime

SHPDK-ja bën rolin e ndërmjetësuesit për Kompanitë Anëtare duke i ofruar fuqi punëtore përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës. Kjo ndihmon kompanitë të gjejnë dhe të sigurojnë punonjës të kualifikuar dhe të përshtatshëm për nevojat e tyre të punësimit, ndërsa gjithashtu ofron mundësi punësimi për qytetarët e Kosovës. Ky bashkëpunim midis SHPDK-së dhe Agjencisë së Punësimit është në dobi të të dyja palëve, duke ndihmuar në rritjen e mundësive për zvogëlimin e papunësisë dhe në përmirësimin e zhvillimit ekonomik të vendit.

PROJEKTET E REALIZUARA NGA SHPDK

Projektet e realizuara nga SHPDK përgjatë vitit 2024 dhe të mbeshtetura sipas donatoreve në vijim: (këtu perfshihen edhe disa projekte që kanë filluar në vitin 2023 dhe kanë perfunduar në vitin 2024):

1. SHPDK - Projekti: Private Sector-Led Workforce Development
   Mbështetur nga: IREX-USAID
   Periudha: Janar 2023 – Dhjetor 2025

2. SHPDK - Projekti: Praktikë dhe Punësim në Industrinë e Përpunimit të Drurit
   Mbështetur nga: GIZ Fit 4 Jobs
   Periudha: Janar 2023 - Shkurt 2024

3. SHPDK – Projekti: Krijimi i platformës së re dhe E commerce (Showroom) për SHPDK-në dhe Antarët
   Mbështetur nga: Swisscontact FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)
   Periudha: Janar 2023 – Qershor 2024

4. SHPDK – Projekti: Dizajnimi i Katalogut për Industrinë e Drurit
   Mbështetur nga: GIZ Entrepreneurship Promotion
   Periudha: Prill 2023 – Mars 2024

5. SHPDK – Projekti: Promovimi NMV-ve në pronësi të grave dhe minoriteteve në Kosovë
   Mbështetur nga: USAID Inclusive Economic Engagement – implemented by CDF
   Periudha: Gusht 2023

6. SHPDK - Projekti: Promovimi dhe ndërkombëtarizimi i industrisë së drurit të Kosovës
   Mbeshtetur nga: GIZ Entrepreneurship Promotion
   Periudha: Nëntor 2023 – Maj 2024

7. SHPDK - Projekti: Sektori i Mobiljeve - Fasilitimi i Rritjes dhe Lidhjeve
   Mbështetur nga: Swisscontact FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)
   Periudha: Nëntor 2023 – Shkurt 2024

8. SHPDK – Organizimi i Konventës së Industrisë së Drurit – Edicioni 7
   Mbështetur nga: MINT – KIESA, USAID Kosovo Compete Activity, ProCredit Bank, Swisscontact, Raiffeisen Bank.
   Periudha: Tetor – Nëntor 2024

9. SHPDK - Projekti: Sektori i Mobiljeve - Fasilitimi i Rritjes dhe Lidhjeve 2
   Mbështetur nga: Swisscontact FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)

Periudha: Nëntor 2024 – Mars 2025

10. Mbledhja e Kuvendit Vjetor të SHPDK-së
    Periudha: Dhjetor 2024

1. SHPDK - Projekti: Private Sector-Led Workforce Development
Mbështetur nga: IREX-USAID
Periudha: Janar 2023 – Dhjetor 2025

Qëllimi

Qëllimi i projektit ishte formimi i Këshilli i Fuqisë Punëtore të Sektorit të Përpunimit të Druriti cili është krijuar me qëllim të bashkimit të sektorit privat, ofruesve të trajnimit dhe zhvillimit të fuqisë punëtore, institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor, shoqërisë civile, diasporës dhe organizatave donatore për të përcaktuar nevojat e zhvillimit të fuqisë punëtore dhe mbështetjen e zgjidhjeve të zhvillimit të fuqisë punëtore për qëllime të arsimit dhe aftësimit profesional (AAP).

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK

- Nënshkrimi i Marrëveshjes 3 vjeqare në mes të SHPDK dhe PSWD
- Publikimi i rregullt i të dhënave të nxjerra nga hulumtimet në kanalet e mediave sociale të SHPDK-së
- Takime të rregullta me Keshillin e Fuqisë Punëtore të Sektorit të Përpunimit të Drurit
- Pjesemarrje e përbashket me IREX dhe 3 Këshillet e formuara: IREX - SHPDK – STIKK – AGRO
- Takime të rregullta me mentorin e përzgjedhur të diasporës 'Peer-to-Peer Diaspora Mentorship Acivity'
- Pjesëmarrje në takimin me Presidenten e IREX dhe Drejtoreshen Rajonale për qëndrueshmërinë e këshillit.
- Pjesëmarrje në Ngjarjen e Germin & PSWD: Shfrytëzimi i burimeve të diasporës për të fuqizuar Këshillat e Fuqisë Punëtore dhe krijimi i zgjidhjeve inovative për Fuqinë Punëtore me mbështetje nga Diaspora.
- Pjesëmarrje në punëtoritë për zhvillim të standardeve të profesionit për Industrinë e Drurit.
- Publikim i shpalljes vjetore për Grante në Industrinë e Drurit
- Informim i kompanive Antare për shpalljen e grantit direkt përmes emailit dhe kanaleve tjera informative, dhe inkurjamimi për të aplikuar.

Rezultate

- Aprovimi i dokumenteve: Rregulloren e punës së Këshillit (verzioni i rishikuar),

- Rregulloren e procedurës e komisionit të granteve,
- Planin e ngritjes të kapacitetit të Këshillave,
- Planin e punës të Këshillave dhe
- Planin e veprimit të politikave.
- Zhvillimi i darfteve finale të standardeve të profesionit për Zdrukthtar dhe Mobileri



2. SHPDK - Projekti: Praktikë dhe Punësim në Industrinë e Përpunimit të Drurit
Mbështetur nga: GIZ Fit 4 Jobs
Periudha: Janar 2023 - Shkurt 2024

Qëllimi

Qëllimi i projektit ishtë të rrisë mundësitë për punësim duke i përshtatur punëkërkuesit me punëdhënësit potencial në sektorin e përpunimit të drurit dhe duke rritur bashkëpunimin ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve të punësimit. SHPDK do të bashkëpunojë ngushtë me APRK për të organizuar dhe implementuar praktikën në punë. Pritjet nga ky program ishin që 50% e praktikantëve të qëndrojnë në punë.

Objektivat kryesore të projektit ishin si më poshtë:

- Të ofrojë një mundësi për të diplomuarit e AAP-së/të papunët e regjistruar për të përfituar nga praktika dhe duke rritur kështu shanset e tyre për të fituar një vend pune.
- Te perfitojnë deri në 40 kompani sektoriale me fuqi puntore të kualifikuar
- Të përfitojnë 100 te rinje mosha 17-29 vjeqare praktike me pagese
- Të rritet bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat dhe agjencisë së punësimit.

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK

- SHPDK ka bërë kërkesë në Agjencionin e Punësimit të Republikës së Kosovës për angazhimin e 100 te rinjëve punëkërkues si trajnim në punë në industrinë e drurit në Kosovë.
- SHPDK mbante takime të rregullta me përfaqesues të Agjencionit për të inicuar këtë aktivitet dhe për ta shtyer përpara, duke i pasur parasysh nevojat e sektorit për fuqi puntore të kualifikuar
- Informim i kompanive antare për projektin dhe për të shfrytëzuar mundesinë të aplikojnë për kërkesë për fuqi punëtore
- Organizimi dhe implementimi I Trajnimit për Shkathtesi të Buta ‘’Soft Skills Training’’ per grupin e pare te praktikanteve te angazhuar
- Vizitë e përbashket me GIZ në shkollën ‘’Zenel Hajdini’’ ne Ferizaj me qellim te prezentimit te projektit
- Vizitë e përbashkët me GIZ në kompanitë e OXA Group ne Ferizaj për ti informuar për projektin dhe për të diskutuar mundësinë për pranimin e praktikantëve
- Vizitë e përbashket me GIZ në shkollen ‘’Shaban Spahija’’ në Pejë me qellim të prezentimit të projektit
- Vizitë e përbashkët me GIZ në kompanite: Ukaj dhe Green House
- Takime të rregullta të SHPDK-se me përfaqesuesit e projektit nga GIZ
- Vizita te bazhdueshme per bashkepunim me shkollen ‘’Fehmi Lladrovci’’, ‘’Zenel Hajdini’’, ‘’Lutfi Musiqi’’, CoC Skendraj etj.

- Organizimi i Panairit të Punës 2023 në Ferizaj, ku SHPDK ishte bashkëorganizator, përfshiu bashkëpunim të ngushtë me disa partnerë kyç, duke përfshirë GIZ Kosova, Komunën e Ferizajt, Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe Odën Ekonomike të Kosovës
- SHPDK menjëherë ka filluar të njoftojë kompanitë anëtare nga Komuna e Ferizajt dhe rrethina për organizimin e Panairit të Punës më 18 tetor. Njoftimi është bërë përmes emailit, telefonatave dhe vizitave personale në kompani.
- SHPDK ka promovuar në vazhdimësi Panairin e Punës në platformat e saj sociale. Promovimi në mediat sociale është një mjet efektiv për të ndihmuar në rritjen e pjesëmarrjes dhe ndikimit të Panairit të Punës.
- Organizimi dhe implementimi I Trajnimit për Shkathtesi të Buta ‘’Soft Skills Training’’ per grupin e dyte dhe të tretë të praktikanteve të angazhuar.

Rezultatet

- Aprovim i kërkesës nga Agjencioni i Punësimit
- Janë trajnuar 72 kandidate në tre grupe te organizuara të Trajnimit ‘’Soft Skills Training’’
- Rreth 40 kompani kane angazhuar praktikantë të rinjë
- Një total prej 128 kandidatë u regjistruan në programin e praktikës, nga të cilët 33 ishin femra dhe 95 ishin meshkuj.
- Të gjitha shkollat e mesme që e kanë profilin e Përpunimit të Drurit dhe Dizajn Interieri kanë shprehur gatishmërinë për bashkepunim për ti derguar nxënësit në praktikë.
- Në Panairin e Punës 2023 në Ferizaj morën pjesë gjithsej 19 kompani nga Industria e Përpunimit të Drurit.
- Industria e Përpunimit të Drurit, e cila ka parë rritje të konsiderueshme në kohët e fundit, ofroi rreth 80 vende pune gjatë Panairit të Punës.
- Për më tepër, rreth 200 punëkërkues vizituan Panairin e Punës.
- 58 praktikantë u punësuan pasi përfunduan praktikën e tyre.



3. **SHPDK – Projekti: Krijimi i platformes së re dhe E commerce (Showroom) për SHPDK-në dhe Antarët**
   Mbështetur nga: Swisscontact FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)
   Periudha: Janar 2023 – Qershor 2024

Qëllimi

Një nga qëllimet e SHPDK-së është të forcojë praninë dixhitale të sektorit dhe promovimin e NMVM-të të sektorit, përmes përmirësimit të faqes sonë të internetit që mundëson që të gjithë anëtarët e shoqatës dhe të tjerët të prezantohen më mirë dhe të kenë shanse më të larta për ndërveprim online me furnitorët lokalë, blerësit, ose partnerët e tjerë të mundshëm ndërkombëtarë. Si rezultat, NMVM-të e mobiljeve përfitojnë me shitje më të larta nëpërmjet qasjes dhe shfrytëzimit më të mirë të mundësive të tregut me prani më të lartë në tregjet e eksportit dhe vendas. Për këtë aktivitet, AWPK ka kontraktuar projektin FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA) dhe implementuar nga Swisscontact në Kosovë.

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK

- SHPDK gjatë kesaj periudhe në vazhdimesi ka mbështetur kompanine Appdec e cila ishte kontraktuar për krijimin e platformes dhe showroomit
- Stafi i SHPDK-se ka siguruar të dhënat nga Antarët për ti vendosur në platformen e re
- SHPDK vazhdimisht ka furnizuar kompaninë Appdec me të dhëna të reja për Anetarët e saj.
- SHPDK ka selektuar të gjitha dokumentet e nevojshme për publikim dhe i ka dërguar tek Appdec
- SHPDK ka ndarë me kompaninë Appdec të gjitha lajmet e reja, promovimet etj.
- SHPDK ka kërkuar nga Antarët të dergojnë produktet (fotografite) të cilat do ti publikojnë në showroom dhe e-commerce.
- SHPDK ka kërkuar nga Antarët të delegojnë një përfaqësues i cili do të trajnohet nga Appdec për menaxhimin e e-commerce.

Rezultatet

- Appdec ka krijuar platformen e re të SHPDK-së si dhe E-commerce
- Appdec ka filluar publikimin e të dhënave në platforme rreth Antarëve dhe kategorive tjera.
- Appdec deri më tani ka promovuar ne web te gjitha lajmet e reja, ngjarjet dhe publikimet.
- Deri me tani 15 kompani i kanë dërguar produktet per publikim ne e-commerce.

4. SHPDK – Projekti: Dizajnimi i Katalogut për Industrinë e Drurit
Mbështetur nga: GIZ Entrepreneurship Promotion
Periudha: Prill 2023 – Mars 2024

Qëllimi

SHPDK në takimet e përbashketa me GIZ, prezentoji nevojën dhe rëndësinë për Dizajnimin e një Katalogu për industrinë e drurit në Kosovë.
Katalogu mund te shërbejë si mjet i rëndësishem marketingu dhe promovimi në panaire të ndryshme kombëtare dhe ndërkombetare, promovim në ambasada etj.
Bazuar në këtë, GIZ kontraktoji kompaninë Piar Creations për dizajnimin e një katalogu për Shoqatën e Përpunuesve të Drurit të Kosovës. Ky katalog do tv përfshijë afërsisht 100 kompani që merren me këtë industri i cili do të jetë edhe në formatin online ku SHPDK e prezanton atë edhe nëpër panaire të ndryshme ndërkombëtare.

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK

- SHPDK informoji Anetarët rreth dizajnimit të Katalogut nga ana e Kompanise PIAR Creations dhe rëndësisë së tij.
- SHPDK filloj me grumbullimin e të dhenave të nevojshme për Katalog tek Antarët
- SHPDK vazhdimisht i ka percjellur të dhenat tek kompania Piar Creation
- SHPDK dërgoji tek Bordi tri versione të Katalogut për përzgjedhje
- SHPDK mbante takime të rrregullta me perfaqesues të Piar Creation për ecurinë e dizajnimit të Katalogut

Rezultatet

- U bë përzgjedhje e versionit të Katalogut nga Bordi I SHPDK-së
- Rreth 70 kompani deri më tani i kanë dërguar të dhënat për katalog
- Kompania Piar Creation e ka finalizuar Katalogun e Industrisë së Drurit
- SHPDK ndau me Antaret Katalogun final dhe u be publikimi i tij në platformën e SHPDK-së.

5. SHPDK – Projekti: Promovimi NMV-ve në pronësi të grave dhe minoriteteve në Kosovë
Mbështetur nga: USAID Inclusive Economic Engagement – implemented by CDF
Periudha: Gusht 2023

Qëllimi i marrëveshjes së nënshkruar në mes të SHPDK-së dhe projektit të USAID-it Inclusive Economic Engagement (IEEA) të implementuar nga CDF është bashkëpunimi afatgjatë me qëllim të ofrimit të shërbimeve të SHPDK-së për kompanitë bashkëpunuese të CDF në pronësi të grave dhe minoriteteve në Kosove.

Deri me tani janë nenshkruar 6 marrëveshje me kompani bashkëpunuese të CDF dhe janë bërë Antarë në SHPDK.

6. **SHPDK – Projekti: Promovimi dhe ndërkombëtarizimi i industrisë së drurit të Kosovës**
   Mbështetur nga: GIZ Entrepreneurship Promotion
   Periudha: Nëntor 2023-Maj 2024

Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është të ofrojë mbështetje për SHPDK-në në zhvillimin e një harte interaktive të industrisë së drurit, të koordinojë dhe të organizojë me sukses konventën e industrisë dhe të sigurojë një pjesëmarrje aktive dhe të suksesshme në panairin ndërkombëtar Swiss Bau. Këto veprime synojnë të ndikojnë pozitivisht në promovimin, zhvillimin dhe rrjedhshmërinë e industrisë së drurit, duke krijuar një platformë të fuqishme për shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe mundësive të biznesit në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

Objektivat e projektit

- Organizimi I Konventës së Industrisë së Drurit dhe garës studentore për Dizajn
- Pjesëmarrje në Panaire Ndërkombëtare dhe B2B
- Antarësim në Organizata Ndërkombëtare Sektoriale
- Krijimi i një Harte Interaktive për Industrinë e Drurit

Konventa e Industrisë së Drurit të Kosovës – Edicioni i 6-të
Mbështetur nga: MINT – KIESA, GIZ Kosovo, USAID Kosovo Compete Activity, USAID – IREX, ProCredit Bank, Bbros – MIKA, CARITAS – MARDI, Swisscontact, Growzillas, Kosovo Information Technology, PABST

Qëllimi

Objektivi kryesor i Konventës së Industrisë së Drurit (KWIC) ishte të ofronte një platformë rrjetëzimi për prodhuesit e mobiljeve në Kosovë, agjencitë qeveritare, donatorët, blerësit ndërkombëtarë dhe atyre vendore, si dhe të gjithë aktorët e tjerë të industrisë së drurit. Pjesë e konventës ishin forume të ndryshme ku ekspertë dhe folës ndërkombëtarë prezantuan tema të ndryshme për industrinë e drurit. Kompanitë kosovare të përpunimit të drurit (21) ekspozuan produktet e tyre për publikun, ndërsa studentët prezantuan dizajnet e tyre të mobiljeve si pjesë e konkursit të dizajnit të studentëve. Në total, janë mbajtur rreth 200 takime Business-to-Business (B2B) në agjendë dy ditore. Në fund, të gjithë studentët pjesëmarrës në konkurs morën certifikatat e pjesëmarrjes, ndërsa fituesit e konkursit studentor morën çmimet e tyre.

Objektivat e arritura të Konventës së Industrisë së drurit ishin:

- Konkurrueshmëria, potenciali, eksportet, financimi dhe zhvillimi i industrisë së përpunimit të drurit në Kosovë.
- E-commerce dhe digjitalizimi në industrinë e drurit.
- Mbështetja nga partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe institucionalë në Kosovë.
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e sektorit të drurit dhe mobiljeve për punësimin dhe rritjen ekonomike.
  Bashkëpunimi mes akademisë dhe sektorit privat për promovimin dhe zhvillimin e inovacionit

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK

- Kërkese tek donatorët, KIESA edhe aktere tjere për përkrahje të Konventës
- Pergatitja e projekt propozimeve dhe dorzimi tek donatorët
- Menaxhimi dhe organizimi i plotë i kësaj ngjarjeje u realizua nga SHPDK, me konsultime, aprovime dhe marrjen e sugjerimeve edhe nga palet e interesit pra partnerët mështetës
- SHPDK organizoi një ekspozitë produktesh të kompanive kosovare. Kompanite që moren pjese ne ekspozimin e produkteve "Made In Kosova" ishin: **Pro Credit Bank, Kosova Information Technology, Jaba Wood, Promobi, Bbros, Vater 1954, Line Group, Ciao Berto, Antracit, Mobile Dekor, Lumi, Elnor, Shehu, Hoti, Green House, Albed, Dijamant, 3D Dizajn MS, LA Guster DIY, Shehu Academy, Dekoriti Training Center.**
- Stafi i Stafi SHPDK-së ka bashkëpunuar me katër universitete të ndryshme si: UBT, Universiteti i shkencave të aplikuara në Ferizaj, AAB si dhe Akademia Evolucion ku jane planifikuar dhe janë organizuar sesione informuese rreth garës studentore për dizjan
- Ekipi i SHPDK-se ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me profesorët dhe përfaqësuesit nga zyra e karrierës në të gjitha universitetet më lartë.
- SHPDK organizoi edhe ekspozite te finalsiteve ne Garen per Diazjn qe u mundesua nga bashkëpunimi i ngushte me keto 4 Universitetet e dizajnit dhe arkitektures.
- Si pjesë e konventës u organizuan edhe Takimet Business-to-Business në të cilën kompanitë vendore ndërvepruan me njëra-tjetrën dhe shkëmbyen informacione me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë të cilët ishin të pranishëm në KWIC 2023.
- Ekipi i SHPDK-së ka shpërndarë çeqet dhe letrat konfirmuese të nënshkruara nga fituesit e e gares per dizajn dhe ka transferuar shumat e fituara në llogaritë e tyre bankare sipas shpërblimeve të garës.

Rezultatet

- Konventa e gjashtë e Kosovës për Industrinë e Drurit ishte një ngjarje shumë e suksesshme duke mbledhur më shumë se 360 pjesëmarrës të regjistruar, si nga sektori i industrisë së drurit ashtu edhe nga publiku.
- Edicioni i gjashtë i Konventës së Industrisë së Drurit në Kosovë u pasqyrua gjerësisht nëpërmjet shumë kanaleve të ndryshme, duke përfshirë televizionet, radio, media të shkruara dhe platformat online të lajmeve. Televizionet, përfshirë RTK, transmetuan ngjarjen drejtpërdrejt. Gjithashtu, dy intervista u zhvilluan në vendin e konventës me drejtoreshën ekzekutive, Znj. Arieta, për emisionet televizive Klan Kosova dhe RTK. Kjo bëri që konventa të marrë një ekspozim të gjerë në media,

duke ndikuar në ndërgjegjësimin dhe interesin e publikut në lidhje me sektorin e industrisë së drurit në Kosovë.

- Pjesëmarrësit në forume dhe panele të ndryshme ishin në gjendje të diskutonin dhe analizonin çështjet përkatëse dhe patën mundësinë të shprehnin shqetësimet e tyre dhe të merrnin përgjigje.
- Gjatë Konventës u zhvilluan mbi 200 takime ndërmjet kompanive dhe partnerëve potencialë, duke përfshirë tregtarët nga Kosova, agjentët dhe bashkëpunimin e mundshëm ndërmjet kompanive ekspozuese.
- Janë ndarë çmimet për 3 finalistet të cilet u vleresuan nga komisioni me më shume pike: Ngadhenjim Ismani, USHAF - Vendi 1re = 1000 Euro, Mona Limoni, Akademia Evolucion - Vendi 2te = 700 Euro, Altin Rexhepi , Akademia Evolucion - Vendi 3te = 500 Euro



Pjesemarrja në Panairin Swiss Bau 2024

Qëllimi

Në vazhdimësi të projektit GIZ EP, aktiviteti vijues ishte Ekspozita e kompanive të drurit të Kosovës në Panairin e Ndërtimit Swiss Bau në Basel/Zvicër (ditë, 16.01. – 19.01.2024)
Si panairi numër një për sektorin e ndërtimit dhe pasurive të patundshme të Zvicrës, Swissbau është një qendër vëmendjeje dhe një forcë tërheqëse për rreth 80% të vizitorëve profesionistë që duhet të frymëzohen nga prezantimet e produkteve inovative dhe ngjarjet informative.

Këtë vit, organizimi i kompanive nga Kosova u bë nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës dhe u mbështet nga projekti GIZ EP, MINT KIESA, PPSE.
Kompanitë që morën pjesë në Panairin e Ndërtimit Swiss Bau ishin: 1. Albed, 2. Ansel, 3. Elnor, 4. Line Group, 5. Hoti Excluzive, 6. Lesna, 7. Promobi, 8. Vater1954, 9. Maxx Qeramika, 10. Emsa, të cilat prezantuan një gamë të gjerë të produkteve në pavilionin e tyre. Këto produkte, duke përfshirë dyer, dritare, kuzhina, mobilje dhomesh gjumi, tavolina, karrige, mobilje banjosh, dhe produkte të tjera për ambiente të hapura, formojnë një linjë të përbashkët të inovacionit dhe dizajnit. Ekspozita e tyre në këtë panair ofron një mundësi të veçantë për të prezantuar cilësi të lartë dhe inovacionet më të fundit nga sektori i ndërtimit në Kosovë për audiencën zvicerane dhe më gjerë.

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK

- Bazuar në Planin e Aktiviteteve të SHPDK-së projekti nisi në nëntor 2023, me realizimin e marrëveshjes me organizatorët e panairit Swiss Bau për vitin 2024.
- Zgjedhja e kompanive bazuar në kriteret e vendosura nga KIESA.
- Kërkesa për rezervim të hapësirës nga kompanitë është për një total prej 300.00 metra katrorë e cila ishte e dedikuar për 10 kompani pjesëmarrëse.
- Organizimi i takimeve mujore me kompanitë për të lehtësuar koordinimin dhe për të siguruar një kuptim të qartë të rregullave të ekspozitës.
- Organizimi i një trajnimi për kompanitë me ekspertin nga GIZ, Genoveva Christova.
- SHPDK koordonoi bashkëpunimin midis mbështetësve dhe kompanive për këto aktivitete.
- AWPK ka inkurajuar kompanitë të aplikojnë për thirrjen e KIESA dhe i ka ndihmuar gjatë procesit të aplikimit.
- AWPK ka mbështetur kompanitë në logjistikën dhe transportin e produkteve në Zvicërr, deri në mbërritjen në panair.
- SHPDK ka mbështetur kompanitë gjatë gjithë kohës së panairit.
- SHPDK ka promovuar pjesëmarrjen e kompanive në Panair para dhe gjate Panairit.

Rezultatet

- 10 kompani të Industrisë së Drurit morën pjesë në Panairin Swiss Bau 2024
- Shtandet e Kosovës u vizituan nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, Zoti Albin Kurti, dhe Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Zonja Rozeta Hajdari.
- Mijëra vizitorë kanë vizituar shtandet e Kosovës
- Dhjetra media raportuan mbi pjesëmarrjen e kompanive Kosovare në Swiss Bau.

- Kompanite presin rezultate shumë të mira bazuar në kontaktet që kanë pasur gjatë ditëve të panairit.
- Deri më tani eksporti i raportuar nga kompanitë si rezultat i panairit është mbi 500,000.00 Euro











Antarësim në Organizata Ndërkombëtare Sektoriale

SHPDK është aktivisht e angazhuar në dialogun e politikave për të adresuar sfidat që hasin kompanitë anëtare.

SHPDK tashmë është zyrtarisht e antarësuar në dy organizata ndërkombëtare. Organizata e parë ndërkombëtare është European Cluster Alliance (ECA), dhe organizata e dytë është FORDAQ.

Antarësimi i suksesshem i SHPDK-së në organizatën ECA thekson qasjen e saj proaktive. Kjo tregon përkushtimin e SHPDK-së për të zgjeruar rrjetin e saj dhe për t'u angazhuar aktivisht me palët kyçe në nivel global.

Anëtarësia në Fordaq.com ofron një platformë gjithëpërfshirëse për bizneset në industrinë e drurit për të zgjeruar arritjen e tyre, për të përmirësuar operacionet dhe për të shfrytëzuar mundësitë e tregtisë globale.

Të qenit anëtarë të dy organizatave ndërkombëtare hap një gamë të gjerë mundësish për ne. Kjo jo vetëm që rrit dukshmërinë e industrisë tonë, por gjithashtu na lejon të angazhohemi në aktivitete promovuese në nivele globale. Për më tepër, pjesëmarrja në këto organizata lehtëson rrjetëzimin me profesionistët e industrisë në mbarë botën, çka mund të çojë në bashkëpunime dhe partneritete që mund të kontribuojnë në rritjen dhe suksesin e mëtejshëm të industrisë sonë në nivel ndërkombëtar.

Krijimi i një Harte Interaktive për Industrinë e Drurit

SHPDK ka organizuar me sukses një aktivitet si Harta Interaktive e fokusuar posaçërisht në kompanitë e përpunimit të drurit në Kosovë me qëllim të mbledhjes së më shumë informacionit, si: detajet e kompanisë, profili i kompanisë, shërbimet kryesore të ofruara nga kompania, nevojat për trajnime etj. SHPDK në bashkëpunim me GIZ EP Project ka përgatitur një pyetësor, të cilin e kanë përdorur studentët në teren gjatë këtij aktiviteti.

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK

- Një takim fillestar koordinimi u mbajt me GIZ për të sinkronizuar fillimin e aktivitetit me qëllimet dhe objektivat e projektit.
- Pas takimit të koordinimit, u zhvillua një takim i radhës me Appdec për të integruar Hartën Interaktive në platformën e SHPDK-së.
- Rekrutimi i studentave
- Shpërndarja e studentave në teren sipas komunave të përcaktuara
- Monitorimi i studentave

Rezultatet

- Mbledhja e të dhënave për 200 kompani të Industrisë se drurit, në 22 komuna të Kosovës.
- Përpunimi i te dhënave
- Vendosja e të dhënave në hartë
- Finalizimi i Hartës

7. SHPDK - Projekti: Sektori i Mobiljeve - Fasilitimi i Rritjes dhe Lidhjeve

Mbështetur nga: Swisscontact FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)
Periudha: Nëntor 2023 – Shkurt 2024

Qëllimi


Aktiviteti kryesor i projektit ishte Ekspozita e kompanive të drurit të Kosovës në Panairin e Mobiljeve të Stokholmit në Stokholm/Suedi (ditë, 06.02. – 10.02.2024):
Panairi i Mobiljeve të Stokholmit është dritarja kryesore për dizajnin skandinav të mobiljeve dhe ndriçimit, si dhe arkitekturën. Mbahet çdo vit në Stokholm, Suedi, panairi tërheq arkitektë, stilistë, dekoratorë brenda, blerës dhe entuziastë nga e gjithë bota.
Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ekspozita e 10 kompanive, anëtare të SHPDK-së, në Panairin Ndërkombëtar, 'Stockholm Furniture Fair' në Shkurt 2024. Përvoja jonë gjatë viteve u përqëndrua në: Ekspozitë të produkteve në panairë ndërkombëtarë, Promovimin e produkteve "Made in Kosova" dhe ngritjen e markave për produktet e Kosovës.
Industria e Drurit e Kosovës u ekspozua për herë të parë në Tregun Skandinav.

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK

- Organizimi i kompanive nga Kosova u bë nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës dhe u mbështet nga: Swisscontact - projekti FEGO dhe MINT KIESA.
- Bazuar në Planin e Operacioneve të SHPDK-së, projekti nisi në nëntor 2023, me rezervimin e hapësirës nga KIESA dhe Swisscontact - Projekti FEGO.
- Zgjedhja e kompanive bazuar në kriteret e vendosura nga KIESA.
- Kërkesa për rezervim të hapësirës nga kompanitë është për një total prej 290.00 metra katrorë e cila ishte e dedikuar për 10 kompani pjesëmarrëse.
- Organizimi i takimeve mujore me kompanitë për të lehtësuar koordinimin dhe për të siguruar një kuptim të qartë të rregullave të ekspozitës.
- SHPDK koordonoi bashkëpunimin midis mbështetësve dhe kompanive për këto aktivitete.
- AWPK ka inkurajuar kompanitë të aplikojnë për thirrjen e KIESA dhe i ka ndihmuar gjatë procesit të aplikimit.
- AWPK ka mbështetur kompanitë në logjistikën dhe transportin e produkteve në Suedi, deri në mbërritjen në panair.
- SHPDK ka mbështetur kompanitë gjatë gjithë kohës së panairit.
- SHPDK ka promovuar pjesëmarrjen e kompanive në Panair para dhe gjate Panairit.

Rezultatet

- 10 kompanitë që morën pjesë në Panairin e Mobiljeve të Stokholmit ishin: 1. AHIKOS, 2. ALLWOOD GROUP, 3. CIAO BERTO, 4. ELNOR FURNITURE, 5. HOTI EXCLUSIVE, 6. LINE GROUP 7. NERO Home, 8. ORENDI, 9. PROMOBI L.L.C, 10. VATER 1954, të cilat kanë përgatitur një linjë impresive të produkteve për tu ekspozuar në pavionin e Kosovës për bizneset dhe klientët e interesuar në Suedi dhe përtej saj. Këto produkte përfshijnë kuzhina dhe mobilje si: dhomat e gjumit, divanët, tavolinat dhe karriget, komodat, shtëpitë modulare, dritaret druri-alumini, dhe produkte të tjera për ambiente të brendshme dhe të jashtme.
- Zëvendësministri i Industrisë, Ndërmarrjeve dhe Tregtisë, Zoti Mentor Arifaj, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Përkohshëm i KIESA-së, Zoti Zef Dedaj, përshëndetën Zonjën Hakan Jevrell, Sekretaren e Shtetit të Suedisë, në stendën e Kosovës, ku diskutuan për identifikimin e aktiviteteve të përbashkëta për të shtuar investimet dhe shkëmbimet tregtare midis dy vendeve.
- Shtandet e kompanive nga Kosova u vizitua gjithashtu nga Zoti. Jonas Westerlund, Ambasadori i Suedisë në Kosovë, dhe Zonjën Shkëndije Geci Sherifi, Ambasadoren e Kosovës në Suedi.
- Mijëra vizitorë kanë vizituar shtandet e Kosovës
- Dhjetra media raportuan mbi pjesëmarrjen e kompanive Kosovare në Stockholm Furniture Fair.
- Kompanite presin rezultate shumë të mira bazuar në kontaktet që kanë pasur gjatë ditëve të panairit.



8. SHPDK – Organizimi i Konventës së Industrisë së Drurit – Edicioni 7 Mbështetur nga: MINT – KIESA, USAID Kosovo Compete Activity, ProCredit Bank, Swisscontact, Raiffeisen Bank. Periudha: Shtator – Nëntor 2024

Qëllimi

Objektivi kryesor i Konventës së Industrisë së Drurit (KWIC) është të ofrojë një platformë rrjetëzimi për prodhuesit e mobiljeve në Kosovë, agjencitë qeveritare, donatorët, blerësit ndërkombëtarë dhe atyre vendore, si dhe të gjithë aktorët e tjerë të industrisë së drurit. Pjesë e konventës do të jenë forume të ndryshme ku ekspertë dhe folës të ndryshëm prezantuan tema të ndryshme për industrinë e drurit. Kompanitë kosovare dhe ndërkombëtare të përpunimit të drurit do të ekspozojnë produktet e tyre për publikun, ndërsa studentët do të prezentojnë dizajnet e tyre të mobiljeve si pjesë e konkursit të dizajnit të studentëve. Pjesë e Konventës do te jenë edhe organizime të takimeve Business-to-Business (B2B) në agjendë dy ditore. Në fund, të gjithë studentët pjesëmarrës e garës do të marrin certifikatat e pjesëmarrjes, ndërsa fituesit e garës studentore do të marrin shpërblimet e tyre.

Objektivat e Konventës së Industrisë së drurit janë:

- Konkurrueshmëria, potenciali, eksportet, financimi dhe zhvillimi i industrisë së përpunimit të drurit në Kosovë.
- E-commerce dhe digjitalizimi në industrinë e drurit.
- Mbështetja nga partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe institucionalë në Kosovë.
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e sektorit të drurit dhe mobiljeve për punësimin dhe rritjen ekonomike.
- Bashkëpunimi mes akademisë dhe sektorit privat për promovimin dhe zhvillimin e inovacionit

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK

- Kërkese tek donatorët dhe institucionet si: KIESA, USAID, GIZ, Swisscontact, Procredit Bank, Raiffeisen Bank dhe aktere tjere për përkrahje të Konventës
- Pergatitja e projekt propozimeve dhe dorzimi tek partneret.
- Organizimi dhe koordinimi i logjistikës së Konventës së Drurit, përfshirë zgjedhjen e vendit të ngjarjes, agjenden e ngjarjes, folësit, ekspozuesit dhe organizimin e sesioneve të paneleve dhe takimeve B2B.
- Organizimi i ekspozimit ku kompanitë e përpunimit të drurit mund të ekspozojne produktet e tyre, përfshirë mobilje, inovacione në dizajn dhe përparime teknologjike dhe digjitalizimit.
- Organizimi dhe Koordinimi I Garës Studentore në Dizajn , duke ftuar studentët e universiteteve të paraqesin dizajne inovative. Gara studentore në Dizajn do të jetë pjesë e konventës, dhe fituesit do të kenë mundësinë të paraqesin dizajnet e tyre para profesionistëve të industrisë.
- Stafi i Stafi SHPDK-së ka bashkëpunuar me katër universitete të ndryshme si: UBT, Universiteti i shkencave të aplikuara në Ferizaj, AAB si dhe UP Fakultetin e Arkitektures ku jane planifikuar dhe janë organizuar sesione informuese rreth garës studentore për dizjan.

- Ekipi i SHPDK-se ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me koordinatoret e të gjitha universiteteve.
- SHPDK organizon edhe ekspozite te finalsiteve ne Garen per Diazjn qe po mundesohet nga bashkëpunimi i ngushte me keto 4 Universitetet e dizajnit dhe arkitektures.
- SHPDK është duke siguruar pjesëmarrje të madhe nga komuniteti i diasporës, per te ndihmuar kompanite vendore të krijojnë lidhje me kompanitë e diasporës dhe partnerët ndërkombëtarë.
- Si pjesë e konventës do të organizohen edhe Takimet Business-to-Business në të cilën kompanitë vendore do te shkembejne informacione me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë të cilët do te jene të pranishëm në KWIC 2024.

Rezultatet

- Rrjetëzimit dhe mundësi të eksportit: Mbi 81 takime B2B rezultuan në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të biznesit, me 11 kompani të diasporës që morën pjesë aktive dhe promovuan bashkëpunimin e ardhshëm.
- Ekspozita e produkteve: 26 kompani morën pjesë, duke ekspozuar produktet e tyre të fundit dhe duke theksuar novacionin dhe mundësitë e industrisë së drurit në Kosovë.
- Gara studentore në dizajn: Pjesëmarrja e studentëve nga komunitetet minoritare shënoi një hap të rëndësishëm drejt përfshirjes, me pesë studentë që shfaqën projektet e tyre dhe morën certifikata.
- Pjesëmarrja ndërkombëtare: Pjesëmarrja në nivel të lartë nga figura qeveritare dhe ndërkombëtare, përfshirë Kryeministrin e Kosovës, forcoi rëndësinë e ngjarjes.









9. SHPDK - Projekti: Sektori i Mobiljeve - Fasilitimi i Rritjes dhe Lidhjeve 2
Mbështetur nga: Swisscontact FEGO (financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – SIDA)
Periudha: Nëntor 2024 – Mars 2025

Qëllimi

Ky projekt ka për qëllim forcimin e industrisë së mobiljeve në Kosovë duke krijuar lidhje tregtare me Suedinë. Kosova ka shënuar rritje të qëndrueshme në këtë industri, por ka sfida në hapjen e tregjeve më të gjera përtej diasporës. Projekti FEGO, i financuar nga SIDA, synon të forcojë bashkëpunimin midis dy vendeve, duke mundësuar mundësi eksporti dhe shkëmbim njohurish përmes organizimit të aktiviteteve si Panairi i Mobiljeve në Stokholm dhe Missioni B2B. Ky bashkëpunim do të ndihmojë bizneset e vogla dhe të mesme kosovare të rrisin mundësitë e eksportit dhe të krijojnë mundësi investimi.

Realizimi dhe Aktivitetet nga SHPDK

- Projekti FEGO dhe SHPDK ka realizuar një vizitë para-misioni nga Interior Cluster Sweden në Kosovë, duke përfshirë hulumtime të tregut dhe koordinimin me palët e interesuara.
- Pjesëmarrësit nga Interior Cluster Sweden, si Susanne-Kikki Israelsson dhe Erik Lundh, vizituan fabrika të mobiljeve për të parë nga afër qasjet inovative të prodhuesve lokalë.
- Aktivitetet e tilla janë të rëndësishme për SHPDK-në, e cila luan një rol kyç në organizimin dhe ekzekutimin e Misionit B2B, duke ofruar mbështetje për anëtarët e saj në hulumtime tregu dhe lidhje ndërkombëtare. Ky bashkëpunim mund të shërbejë si model për nisma të tjera të ngjashme në të ardhmen.
- Në kuadër të vizitave të 11 kompanive kosovare, janë shënuar zhvillime pozitive, përfshirë interesin e blerësve suedezë për produktet e kompanive si Elnor, Berto, Terrastone dhe Group-Ks.
- Ky bashkëpunim mund të sjellë mundësi afatgjata për rritjen e eksportit dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës në sektorin e mobiljeve në Kosovë.
- Gjithashtu, Kosova do të ketë mundësinë të ekspozojë potencialin e mobiljeve në Panairin e radhes të Mobiljeve në Stokholm ‘’Stockholm Furniture Fair 2025’’ duke hapur mundësi për bashkëpunime ndërkombëtare.
- Panairi është një platformë e rëndësishme për promovimin e dizajnit të qëndrueshëm dhe inovativ.

Rezultatet

- Gjatë vizitës, 11 kompanitë nga Kosova ishin shumë të përgatitura dhe paraqitën në mënyrë profesionale produktet e tyre.
- Dizajnet e produkteve dhe cilësia e tyre ishin në përputhje me trendet e tregut aktual, ndërsa çmimet ishin konkurruese.
- Sa i përket menaxhimit profesional të porosive, përfshirë aspekte si koha e dorëzimit, kushtet e pagesës dhe ruajtja e cilësisë së qëndrueshme të produkteve, kompanitë treguan informacion të plotë dhe përgatitje për të ardhmen.

- Kompanitë raportuan një nivel të lartë suksesin në panairin e kaluar ne Stokholm dhe presin të marrin porosi të konsiderueshme si rezultat i pjesëmarrjes së tyre.
- Ky rezultat pozitiv reflekton paraqitjen e tyre efektive, ofertat konkurruese dhe gatishmërinë për të menaxhuar operacionet e biznesit në mënyrë profesionale.









10. Mbledhja e Kuvendit Vjetor të SHPDK-së
Periudha: Dhjetor 2024

Mbledhja e rregullt vjetore e Kuvendit të SHPDK-së u mbajt më 4 dhjetor 2024, duke filluar në orën 14:00 dhe duke përfunduar në orën 17:00, në Hotel Emerald, salla Straus 1, në Prishtinë, ku morën pjesë 44 anëtarë.











PJESËMARRJA NË KONFERENCA

- Pjesëmarrje në takimin e Këshillit për Fuqi Punëtore në Sektorin e Përpunimit të Drurit – **IREX PSWD Project**
- Pjesëmarrje në takimin e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime - **Sekretariati i Keshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime**
- Pjesëmarrje në Trajnimin: Skills fair on quality apprenticeships - **ITCILO CAMPUS në Turin, Itali**
- Pjesëmarrje në takimin e rregullt **– Growth Agency - ZKM**
- Pjesëmarrje në punëtorinë: Perspektiva e OJQ-ve që përfaqësojnë të rinjtë, gratë dhe minoritetet – **IREX PSWD Project**
- Pjesëmarrje në punëtorinë: Ligji i ri për Parqet Industriale dhe Teknologjike -**Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë & KIESA**
- Pjesëmarrje në takimin e përbashkët për organizimin e pjesëmarrjes në Panairin e Berlinit – **Klubi I Prodhuesve, SHPDK, STIKK.**
- Pjesëmarrje në punëtorinë GESI – **Usaid Kosovo Compete Activity**
- Lansimi i panelit për hulumtime online – **UBO Consulting & USAID Kosovo Compete Activity**
- Pjesëmarrje në konferencën:Te behemi kreativ per zhvillimin rajonal – **Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe UN-HABITAT**
- Pjesëmarrje në Takimin e **Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime – Zyra e Kryeministrit**
- Takim i Këshillit për punëtorinë lidhur më shkëmbimin e të dhënave / Përpunimi i Drurit – **IREX PSWD Project**
- Pjesëmarrje ne ngjarjen: **Lansimi i MIK – MPJD**
- Pjesëmarrje në Eventin e 10-vjetorit te themelimit te **Degeve te Rrjetit te Bizneseve te Diaspores Shqiptare ne Evropë – RRBDSH & USAID Kosovo Compete Activity**
- Pjesëmarrje në punëtori lidhur me nevojat prioritare në sektorin e pylltarisë në Kosovë - **Food and Agriculture Organization of the United Nations (FAO)**

- Pjesëmarrje per bashkebisedim me Ministrin Faton Peci**: Sektori i pylltarise dhe perpunimi i drurit!**
- Pjesëmarrje në Tryezë Diskutimi "**Gjykata Komerciale dhe Rëndësia e Drejtësisë Komerciale**
- Pjesëmarrje në takimin e KZHI - **MINT**
- Pjesëmarrje në punëtorinë lidhur me koncept dokumentin nga fusha e antidampingut dhe masave kundërbalancuese - **MINT**
- Pjesëmarrje në Forumin Ekonomik Kosovë-Portugali **– MPJD**
- Pjesëmarrje në Punëtorinë 2 ditore për zhvillim të standardeve të profesionit në Përpunim të drurit - **IREX PSWD Project**
- Pjesëmarrje në trajnimin për platformën e Regjistrit të Kualifikimeve të Kosovës **– AKK**
- Pjesëmarrje në takimin informues rreth shpalljes së KIESA-s – **KIESA & USAID Compete**
- Pjesëmarrje në ngjarjen Lansimi i Dritares për Investime të Diasporës **- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve**
- Pjesëmarrje në Takimin Rajonal për Promovimin e Mundësive për Punë Praktike për të rinjtë e moshave 16-24 vjec - **Kosovo CSR Network**
- Pjesëmarrje në Punëtorinë validuese për projektin e SDC-së **"Matching Skills to Jobs' – Swisscontact**
- Pjesëmarrje në vizitat te kompanitë Anëtare së bashku me delegacionin nga Suedia **(Interior Cluster Sweden), dhe përfaqësues nga FEGO**
- Pjesëmarrje në **EYE Project Closing Event**
- Pjesëmarrje në 25 Vjetorin e **CARITAS**
- Pjesëmarrje në **Konferencën Ndërkombëtare: "Driving Excellence: Aligning Quality Assurance Policies with Institutional Strategy and Stakeholder Engagement"**
- Pjesëmarrje në **Konferencën Ndërkombëtare European Cluster Collaboration Lab, organizuar nga European Clusters Alliance në Strasbourg Francë**
- Organizimi dhe menaxhimi I kompanive antare per pjesemarrje ne **Festivalin e Gastronomise Shqiptare ne Berlin.**
- Organizimi dhe vizitat te kompanitë Anëtare së bashku me delegacionin nga Luksemburgu **Furniture Federation FEDAM, ne bashkepunim me Ambasaden e Luxembourgut ne Kosove.**
- Pjesëmarrje në takimin e Këshillit për Fuqi Punëtore organizuar në bashkëpunim me **IREX PSWD Project.**
- Pjesëmarrje në takimin ''Roundtable Discussion on Kosovo Light Manufacturing Sector Value Proposition for Investment and Export'' organizuar nga **USAID Kosovo Investment Promotion and Access to Finance Activity dhe Zyra e Kryeministrit.**
- Pjesëmarrje në Puntorinë ''Prezantimi i gjetjeve kryesore - Vlerësimi i Kapaciteteve të shkollave AAP dhe nevojave të sektorit privat në Kosovë - "Shkathtësi për punë të qëndrueshme" **- LuxDev KSV/021**
- Pjesëmarrje në Puntorinë "Empowering the Workforce in Kosovo: Human Capital and Mentorship" organizuar nga **Germin.**
- Pjesëmarrje në takim me **Ministrinë e Financave** – profilet/pozitat më të kërkuara në tregun e punës nga bizneset e sektorëve të Agrobiznesit, Energjisë, TIK-ut, dhe Përpunimit të Drurit/
- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët mbi arbitrazhin, të organizuar nga **Programi për Drejtësi Komerciale dhe Oda Ekonomike Amerikane.**

INFORMATA PËR ANËTARËT

SHPDK ka dërguar gjithsej 28 njoftime për anëtarët e saj përmes emailit gjatë vitit 2024:

1. Njoftim për anëtarë: Thirrje publike nga KIESA / aplikim për pjesëmarrje në Panairin 'Stockholm Furniture Fair 2024'
2. Ftesë për Anëtare – Vizitë kompanive kosovare në shtandet e Kosovës në Panairin 'Swiss Bau 2024'
3. Ofrimi I biletave falas për Antarë për pjesëmarrje si vizitor në Panairin 'Swiss Bau 2024'
4. Njoftim për anëtarë: Subvencionimi i pajisjeve efiçiente për NMVM
5. Ftesë për Anëtarë – Vizitë kompanive kosovare në shtandet e Kosovës në Panairin Stockholm Furniture Fair 2024
6. Njoftim për anëtarë - Konferenca e Kontabilitetit Digjital 23 dhe 24 Shkurt 2024
7. Thirrje për trajnime me ekspert Italian në fushën e dizajnit dhe prodhimit të mobiljeve
8. Ftesë për të ekspozuar në Berlin në Panairin 'Global Albanian Gastronomy Festival'
9. Ftese - Vizitë në Panairin e mobiljerisë Izmir Modeko
10. Ofertë për realizimin e produktit për blerësin në Gjermani
11. Anketë me bizneset e sektorit të përpunimt të drurit në lidhje me Ligjin Nr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave
12. Ftesë për të marr pjesë në Forumin Sllloveno-Kosovar në Sllloveni me 22 Mars
13. Ftesë për të vizituar Panairin e Mobilerisë 'Shqiperia 2024'
14. Ftesë për të marr pjesë në Panairin e Mobilerisë MODEF EXPO 2024 në Bursa 22-27 Prill.
15. Njoftim: Thirrja për Aplikim: Iniciativa për Fuqizim Digjital
16. Ftesë për pjesëmarrje: Lansimi i MIK – MPJD 14 Maj
17. Ftese per pjesemarrje dhe konfirmim: Eventi me diasporen 17 Maj
18. Ftese per bashkebisedim me Ministrin Faton Peci: Sektori i pylltarise dhe perpunimi i drurit! 7 Qershor
19. Ftesë - Tryezë Diskutimi "Gjykata Komerciale dhe Rëndësia e Drejtësisë Komerciale 12 Qershor
20. Ftesë për takim publik lidhur me koncept dokumentin nga fusha e antidampingut dhe masave kundërbalancuese - MINT 18 Qershor
21. Ftesë Forumi_Ekonomik_Kosovë-Portugali 19 Qershor
22. Thirrje për Pjesëmarrje në Programin e Mësimit Dual për Vitin Shkollor 2024/2025
23. Thirrje publike për aplikim në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin "Festivali Global i Gastronomisë Shqiptare 2024"
24. Thirrje për aplikime - Grante për ofruesit e programeve trajnuese inovative në Kosovë
25. Thirrje per Grante nga MINT/KIESA
26. Thirrje për Ekspozim në Konventën e Industrisë së drurit 2024
27. Ftesë për aplikim si ekspozues në Panairin ''Stockholm Furniture Fair 2025''
28. Ftesë për pjesëmarrje: Forumi i Biznesit ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë B2B takime mes bizneseve kroate dhe bizneseve kosovare.

PREZENCA NE MEDIA

Që nga fillimi i vitit 2024, SHPDK ka shënuar një përparim të dukshëm në rritjen e pranisë së saj në mediat sociale si pjesë e përpjekjeve të saj në fushën e marketingut. SHPDK ka përjetuar një rritje të fortë në faqen e saj në Facebook, duke shtuar numrin e ndjekësve dhe duke arritur një audiencë të gjerë. Po ashtu, raportimet e mediave për ngjarjet në të cilat ka marrë pjesë SHPDK kanë qenë të gjera duke e promovuar në këtë mënyrë industrinë.

https://www.swisscontact.org/en/news/wood-processing-companies-from-kosovo-shine-at-swissbau-fair?fbclid=IwAR2k9rs3AUdwnha4gSihqsboj0gUXx_KVOppBOSiCBZ6fS0FzYhZYnPD60I

https://www.facebook.com/rrefimsuksesi/videos/315737327544568

https://www.facebook.com/photo/?fbid=776695607836114&set=a.291225356383144

https://telegrafi.com/albed-pjese-e-panairit-swiss-bau-2024-vizitohet-nga-kryeministri-kurti/

https://www.facebook.com/photo?fbid=373617108649906&set=pcb.373617191983231

https://www.facebook.com/rtklivecom/videos/407572898345924

https://www.botasot.info/aktuale-lajme/2114041/mbi-25-kompani-nga-kosova-ne-panairin-swiss-bau/

https://www.linkedin.com/posts/kosovo-investment-and-enterprise-support-agency_panairi-nd%C3%ABrkomb%C3%ABtar-swiss-bau-2024-n%C3%AB-basel-activity-7153102789919858688-CLB1

https://kosovanews.net/kurti-dhe-hajdari-marrin-pjese-ne-hapjen-e-panairit-nderkombetar-swiss-bau-2024-ne-zvicer-vizitojne-kompanite-kosovare-qe-po-ekspozojne-prodhimet-e-tyre/

https://ferizajpress.com/kompanite-nga-ferizaj-marrin-pjese-ne-panairin-swiss-bau-ne-zvicer/

https://www.arbresh.info/lajmet/kurti-dhe-hajdari-vizitojne-nje-kompani-kosovare-ne-zvicer-vleresojne-larte-kontributin-e-diaspores/

https://www.facebook.com/photo/?fbid=777555837744662&set=pb.100064707575188.-2207520000

https://kallxo.com/lajm/12-kompani-nga-kosova-pjesemarrese-ne-panairin-swissbau-2024-ne-zvicer/

https://telegrafi.com/ne-panairin-swissbau-2024-ne-zvicer-te-ekspozohet-shtepia-e-kosoves/ https://rtv21.tv/12-kompani-nga-kosova-pjese-e-swissbau-2024-ne-zvicer/

https://www.botasot.info/diaspora/2112908/12-kompani-nga-kosova-pjese-e-swissbau-2024-ne-zvicer/

https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/538015/per-here-te-pare-prefab-organizon-panairin-e-ndertimtarise-te-parafabrikuara-ne-zvicer/

https://top24.mk/12-kompani-nga-kosova-pjese-e-swissbau-2024-ne-zvicer/

https://telegrafi.com/prodhimet-e-12-kompanive-nga-kosova-te-promovohen-ne-zvicer-javen-tjeter/ https://www.zeri.info/ekonomia/521535/12-kompani-nga-kosova-do-te-promovohen-ne-panairin-swissbau-2024-ne-zvicer/

https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=656455 https://ekonomiaonline.com/12-kompani-nga-kosova-do-te-promovohen-ne-panairin-swissbau-2024-ne-zvicer/

https://telegrafi.com/kompani-te-perpunimit-te-drurit-nga-kosova-marrin-pjese-ne-panairin-nderkombetar-te-ndertimit-swiss-bau-2024-ne-basel-te-zvicres/

https://indeksonline.net/greenhouse-ekspozon-ne-swissbau-2024-panairi-me-i-madh-i-ndertimit-ne-evrope/ https://www.epokaere.com/kompanite-e-perpunimit-te-drurit-nga-kosova-marrin-pjese-ne-panairin-nderkombetar-te-ndertimit-swiss-bau-2024/

https://ballkani.info/dymbedhjete-kompani-nga-kosova-do-te-marrin-pjese-ne-panairin-swissbau-2024-ne-zvicer/

https://www.suharekaonline.com/zvicer/zvicer-10-kompani-prodhuese-nga-kosova-do-te-marrin-pjese-ne-panairin-swiss-bau-2024/

https://prestigji.com/2024/01/11/12-kompani-te-drurit-perfaqesojne-kosoven-ne-zvicer/ https://kosova.info/12-kompani-te-drurit-perfaqesojne-kosoven-ne-zvicer/

https://telegrafi.com/kryeministri-albin-kurti-viziton-fasal-dhe-nero-home-ne-panairin-swiss-bau/

https://telegrafi.com/elnor-sjell-dizajn-dhe-cilesi-ne-panairin-e-ndertimit-swiss-bau-ne-zvicer/ https://kosovapress.com/admin/prodhimet-e-kompanive-nga-kosova-do-te-promovohen-ne-nje-panair-ne-suedi/

https://www.facebook.com/Ora7Official/videos/899310361649337

https://ubtnews.com/prodhimet-e-kompanive-nga-kosova-do-te-promovohen-ne-nje-panair-ne-suedi/

https://katror.info/12-kompanive-prodhuese-nga-kosova-ne-panairin-nderkombetar-furniture-fair-ne-suedi/

https://www.albinfo.ch/keto-kompani-nga-kosova-do-te-ekspozojne-per-here-te-pare-ne-suedi/

https://www.albinfo.at/suedi-dhjete-kompani-nga-kosova-po-prezantohen-suksesshem-ne-panairin-stockholm-furniture-fair/

https://m-independent.fr/keto-kompani-nga-kosova-do-te-ekspozojne-per-here-te-pare-ne-suedi/

https://www.facebook.com/photo/?fbid=788884846617190&set=pcb.788886653283676&locale=bn_IN

https://www.facebook.com/photo?fbid=740323394946745&set=pcb.740324088280009

https://www.facebook.com/MINT.RKS/videos/931494028048365

https://telegrafi.com/promobi-kuzhinat-inovative-dhe-dizajnin-unik-prezantohet-ne-panairin-prestigjioz-te-stockholm-furniture-fair-2024/

https://www.youtube.com/watch?fbclid=IwAR19m-d0SnhLGLhkynMF8BEnOCvLcuWsdTgZ-i8gy13wqJoy1Hbc2QkzQ5I&v=Jg5UaYYIyvM&feature=youtu.be

https://www.youtube.com/watch?v=kjk9Wa3wHWQ

https://www.facebook.com/photo/?fbid=692914523019570&set=pcb.692914836352872

https://www.facebook.com/photo/?fbid=788884846617190&set=pcb.788886653283676

https://www.facebook.com/photo/?fbid=740323394946745&set=pcb.740324088280009

https://www.facebook.com/100080653913970/videos/pcb.406466645385129/1323203815007959

https://www.facebook.com/globalalbanian/videos/469684292658490

https://www.youtube.com/watch?v=Ts5J00okz_c

https://klankosova.tv/konventa-e-drurit-kurti-kosova-po-e-gdhend-nje-vend-te-vecante-ne-tregun global/

https://kosova.info/sot-hapet-konventa-e-industrise-se-drurit-te-kosoves/

https://www.facebook.com/reel/453798017426228

https://www.facebook.com/kosovowoodassociation/videos/1971087116722907

REZULTATET DHE TË ARRITURAT E SHPDK-së gjatë periudhes Janar – Dhjetor 2024

PRAKTIKA dhe PUNËSIMI në industrinë e Drurit

- 128 kandidatë në praktikë
- 58 kandidatë të punësuar

EKSPOZIME

- 77 kompani morën pjesë në ekspozim
- Mbi 200 takime B2B

REZULTATI I EKSPORTIT NGA EKSPOZIMET 2024

- **4,000.000.00 Euro**

MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT TË NËNSHKRUARA ME PARTNERË

- MoU me USHAF
- MoU me UBT
- MoU me Akademia Evolution
- MoU me AAB
- MoU me Pro Credit Bank
- MoU me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- MoU me CDF – USAID
- MoU me Fakultetin e Arkitektures – Universiteti I Prishtinës
- MoU me Oden Sllovene të Bizneseve

PROMOVIM

- Promovim i Anëtarëve në Media Sociale në vazhdimësi
- Mbi 360 pjesmarrës në Konventë

- Platforma e re e SHPDK dhe E-commerce
  https://kosovowood.org/
- Katalogu i industrisë së Drurit
  https://kosovowood.org/Uploads/Page/Document/20/awpk_final_ALB.pdf
- Harta e Industrisë së Drurit
  https://kosovowood.org/Harta-Interaktive
- Analiza/Statistikat e Industrisë së Drurit
  https://www.workforcedata-ks.org/wooddashboard

ANËTARËT E SHPDK-së

https://kosovowood.org/Anetaret